



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë/ Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i

Tehnologiju/ Ministry of Education, Science and Technology

Departamenti i Shkencës dhe i Teknologjisë

Departamenti i Shkencës dhe i Teknologjisë dhe Këshilli Shkencor i MAShT në vazhden e aktiviteteve të tyre bazuar në dispozitat e Ligjit për Veprimtari Kërkimore-shkencore dhe bazuar në planin e veprimit të Programit Kombëtar të Shkencës në lidhje me përkrahjen e shkencëtarëve kosovarë që kanë shënuar arritje të jashtëzakonshme në shkencë, shpallë:

VAZHDIM I KONKURSIT

(Për ndarjen e shpërblimit vjetor “Shkencëtari i vitit” dhe “Shkencëtari i ri i vitit” 2013)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka krijuar një fond për çmime të përvitshme për arritje të jashtëzakonshme hulumtuese-shkencore brenda një periudhe njëvjeçare (llogariten rezultatet shkencore nga shtatori i vitit paraprak deri në tetor të vitit aktual). Këto çmime synojnë të promovojnë cilësinë në punën shkencore, të inkurajojnë ngritjen në karrierë dhe shpërblimin e përpjekjeve dhe përkushtimin e hulumtuesve shkencorë të cilët janë në proces të avancimit të diturive të tyre në fushën përkatëse të ekspertizës. Në lidhje me këtë, ftohen institucionet kosovare të shkencës dhe shkencëtarët kosovarë që të aplikojnë apo paraqesin propozimet e tyre për përfituesit e sivjetmë të shpërblimit vjetor:

“Shkencëtari i vitit” (tri shpërblime) dhe

“Shkencëtari i ri i vitit” (tri shpërblime)

Kush mund të aplikojë?

Mund të aplikojnë/rekomandojnë institucionet kërkimore-shkencore kosovare apo shkencëtarët kosovarë që kanë rezultate të shkëlqyera si dhe shkencëtarët e rinj të çdo disipline shkencore që

kanë rezultate të shkëlqyera. Aplikimi për çmimin vjetor bëhet për rezultate kulmore në shkencë të arritura nga shtatori i vitit 2012 deri në tetor 2013.

Financimi që është vënë në dispozicion

Çmimi “Shkencëtar i vitit” do të jepet çdo vit për tre shkencëtarët më të suksesshëm kosovarë. Secili prej tyre do të marrë një çmim prej 2000 euro për të mbështetur vazhdimin e karrierës së tyre hulumtuese dhe për të bërë të mundur që fituesit e çmimit të ndërtojnë, konsolidojnë ose drejtojnë nisma të reja hulumtuese.

Çmimi “Shkencëtar i ri i vitit”, konsiston në një shpërblim monetar prej 1500 euro dhe do të jepet në mënyrë të përvitshme për tre shkencëtarët kosovarë që janë në hapat e tyre të parë të karrierës kërkimore dhe që në vitin paraprak kanë arritur rezultate kulmore shkencore dhe hulumtuese.

Konkursi vazhdohet për dhjetë ditë nga dita (16 nëntor 2013) e rishpalljes publike të tij në gazeta, në ueb faqen e MASHT dhe mediat elektronike. Nominimi përfundon më 26 nëntor në orën 12.00.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në arkivin e MASHT.

Aplikacioni dhe informatat shtesë mund të shkarkohen nga vegëza e ueb faqes së MASHT <http://www.masht-gov.net/advCms/#id=36> apo të merren tek zyrtari kontaktues në MASHT z.

Ukë Osmanaj në zyrën 302.

Aplikimi duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur ku të jetë shkruar “Aplikimi për shpërblimin “Shkencëtari i vitit apo “Shkencëtari i ri i vitit” në adresën : Rr. Agim Ramadani p.n, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Përpos kësaj, një version elektronik i aplikimit duhet të jetë dorëzuar brenda afatit (15 ditë nga dita e publikimit, ora 12:00 e mesditës) në adresën: uke.osmanaj@rks-gov.net ose uke.osmanaj@gmail.com shqip, anglisht, ose serbisht.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Për Departamentin e Shkencës dhe të Teknologjisë:

Dr. sc. Murteza Osdautaj, drejtor